REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**
**KËSHILLI I BASHKISË**
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

**Patos, më 25/04/ 2024**

**Nr. 724/6 Prot.**

# PROCESVERBALI I TAKIMIT 23 PRILL 2024

**Vendi:** *"Salla e mbledhejeve të këshillit të bashkisë Patos "*

**Ora e fillimit :** ***10:00***

***Ora e mbarimit : 12:00***

**Tema e Konsultimit:** ***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit me nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB-së nr. 80 datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

**Pjesëmarrës**:Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro, Keyetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmeti Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, Deputete e Qarkut Fier, Kyetarë të fshatrave, dhe rreth 25 banorë të njësisë qytetit.

**Takimin hapet nga Sekretarja e Këshillit: znj. Refaela Xeba**

**Sekretarja e Këshillit znj. Refaela Xeba:** të nderuar pjesëmarrës më lejoni së pari t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me temë: "Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" i cili zhvillohet në zbatim



*Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

nenit 18 dhe 52 të ligjit me nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB-së nr. 80 datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025". Fjala është për Kryetrin e Bashkisë.

| | |
|---|---|
|  | **Sekretarja e Këshillit**<br>**znj. Refaela Xeba**<br>Dëgjesë Publike me temë :<br>***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***<br>**Prill 2024** |

**Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro:** Faleminderit për ardhjen tuaj, më lejoni që përpara se të kalojmë më marrjen e kërkesave buxhetore t'ju bëjë me dije se kjo është faza e parë e marrjes së kërkesave prioritare për buxhetin afatmesëm 2025-2027 e cila do të pasojë me fazat e tjera të diskutimit me banorët e qytetit dhe jo vetëm.

Bashkia ka një eksperiencë pozitive bashkëpunimi me qytetarët e saj duke realizuar takime konsultative të cilat kanë për synim jo vetëm transparencën e pushtetit vendor me qytetarët e tij por padyshim edhe fitimin e besimit qytetar. ku fjala juaj ka peshë dhe ndikim pozitiv në

| | |
|---|---|
|  | **Kryetar i Bashkisë**<br>**z. Fation Duro**<br>Dëgjesë Publike me temë :<br>***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***<br>**Prill 2024** |



*Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

hartimin e buxheteve të mira dhe padyshim që hartimi i një buxheti kërkon një punë të madhe dhe një angazhim imenjativ qytetar duke filluar qysh tani e deri në fund të vitit ku Këshilli i Bashkisë Patos do të miratojë dhe dokumentin përfundimtar të buxhetit për vitin 2025 dhe të afatmesëm

**Banor e zonës znj. Rajmonda Avdulaj:** - jam banuese ne fshatin Dukas dhe dua të ngre një shqetësim lidhur mbi mungesën e ndricimit rrugor kur taksat ne i paguajmë perse nuk merrni masa për vendojen e disa llampave



**Banor e zonës**
**znj. Rajmonda Avdulaj**

Dëgjesë Publike me temë :

*"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*

Prill 2024

**Kryetari fshatit Kuqar z. Islam Shpata** – Ju falenderoj për punët e mira që janë bërë deri tani. Problemet madhore kanë kaluar, ndërhyrjet në varrezat e fshatit (sistemi edhe rrethimi I tyre). Shqetësim tjetër që dua të parashtroj lidhet me rrugët e brendshme të fshatit për t'u lidhur me rrugët kryesore, gjithashtu të shikohet mundësia në ndërhyet për hapjen e rrugëve të parcelave si dhe rrugët e shtruara të fshatit kërkojnë ndricim? Ndërsa lidhur mbi ujin e pijshëm ku është bërë ndërhyrja nga ujësjellësi janë prishur rrugët?



**Kryetari fshatit Kuqar**
**z. Islam Shpata**

Dëgjesë Publike me temë :

*"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*

Prill 2024



*Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

**Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro:** lidhur mbi ndricimin e rrugëve, patjetër që do të bëhet zevendësimi i llampave të djegura por nga ana jonë do të shikohet edhe mundësia për blerjen e ndricuesve dhe gjatë sezonit të verës do të shikohet pjesa e ndricimit me panele diellore në rrugët periferike. Lidhur mbi hapjen e rrugëve të reja do të marrim edhe një mjet tjetër edhe para se të kaloj në njësinë Ruzhdije do të kaloj të kryej pnime në qytet. Në segmentet rrugore ku ka ndërhyrë firma për rrjetin e Ujësjellësit rrugët do të kthehen në gjendjen e mëparshme po nga firmës që po kryen punimet.



**Kryetar i Bashkisë**
**z. Fation Duro**

Dëgjesë Publike me temë :

***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***

**Prill 2024**

**Kryetari i fshatit Margellic z. Agron Faslliaj: -** për cfarë rruge bëhet fjalë pasi ne si fshat problemin e parë kemi transportin publik, nuk kemi mjek për të na shërbyer në qendën shëndetësore, lagjja e vjetër kërkon ndërhyrje edhe ndricim. Kërkohet ndërhyrje për hapjen e rrugëve të parcelave. Padiskutim që banorët ju falenderojnë edhe për punët e mira që keni bërë për fshatin tonë pas ndërhyrje që ju bëtë në rrugën e lapidarit, edhe në lagjjen Pëllumbaj



**Kryetari i fshatit Margellic**
**z. Agron Faslliaj**

Dëgjesë Publike me temë :

***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***

**Prill 2024**

**Kryetari i fshatit Dukas z. Ilmi Myftaraj** – Dukas te liqeni kërkohet nga banorët ndërhyrje për kalim dy urat që kemi rikonstrukturuar më parë kërkojnë ndërhyrje pasi po dëmtohen. Dy familje kanë nevojë për rikonstruksion të banesave. Te bregallarët kanali kërkon pastrim dhe rrugët kërkojnë ndricim



**Kryetari i fshatit Dukas**
**z. Ilmi Myftaraj**

Dëgjesë Publike me temë :

***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***

**Prill 2024**

**Kryetari i fshatit Banaj z. Shpëtim Isufaj -**. Po parashtroj edhe unë kërkesat e fshatit Banaj: Rruga e lagjes Banaj Rruga e brendshme Ndriccim të rrugëve Rrugët e parcelave Rruga te gropa e Derrit



**Kryetari i fshatit Banaj**
**z. Shpëtim Isufaj**

Dëgjesë Publike me temë :

***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***

**Prill 2024**

**Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro-** Rruga në Banaj deri te shtëpia e parë do të do të shohim mundësinë ta mbyllim brenda mujit dhjetor ndërsa për rrugët e brendshme do të shikohet në një moment të dytë. Rrugët te Gropa e Derrit në fakt janë pak të vështira për shkak të zënies së tyre por do të shohim mundësinë për ndërhyrje.

**Kryetari i fshatit Grizë z. Refat Shpërdheja: -** shkurtimisht do then ndërhurjet më emergjente në Grizë. Rruga e hangarit do cakull, Rruga Saliaj me asfalt Rrugët e parcelave të hapen dhe kërkoj që të bëhet një treg pasi tregëtarët po shesin në në rrugë dhe pa asnjë kusht



**Kryetari i fshatit Grizë**
**z. Refat Shpërdheja**

Dëgjesë Publike me temë :

***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***

**Prill 2024**

**Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro -** Heronjtë e Prishtinës do të bëhet këtë vit

**Anëtar i këshillit z. Smerald Hazizaj-** Mustafa Matohiti kërkon infermiere në zonë Rruga kryesore Patos i Vjetër- Patos i ri, Rruga Patos i Vjetër- Oficcin e vjetër kërkon ndërhyrje emërgjente për kanalizime. Investimet në rrugët e shtruara kërkojnë ndricim Rruga në lagjen Rrapushaj te ish Cerdhja Kërkon mur mbajtës Rruga nga Pallati te burimi i Xanes kërkon ndërhyrje. Te ish kapanonet banesat janë të mbuluara me inerte dhe të shikohet mundësia për riparim Për fshatin Rerës: Azharonimi i tokës Ndricimi në lagjen Pajaj Rruga në lagjen Buzaj Lagjja Pajaj. Rrugët në lagjen Xhelaj kërkon ndërhyrje urgjente



**Anëtar i këshillit**
**z. Smerald Hazizaj**

Dëgjesë Publike me temë :

***"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".***

**Prill 2024**

**Banor i zonës Rerës z. Gjergji Hoxha**:- për fshatin Rerës kërkoj të ndërhyet për hapjen e kanaleve, Gjithashtu të shikohet mundësia për rrugët në Dukas, si edhe të shikohet për pastrimin e kanalit atje ku dhe e kemi diskutuar më parë. Në Rerës te varrezat publike kërkohet ndërhyrje, pa harruar ndërhyrjet në rrugën kryesore, rrugët e parcelave, ruga te Burimi i lajthisë dhe rruga te Kavo e Zhavorrit



**Banor i zonës Rerës**
**z. Gjergji Hoxha**

Dëgjesë Publike me temë :

*"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*

Prill 2024

**Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro:** Për kanalinë do të ccojmë mjetin. Rruga Rrapushaj nuk vonohet investimi. Lidhur mbi muret mbajtës janë parashikuar. Varrezat janë parashikuar që këtë vit do të vendoset edhe uji. Rrugët Mustafa Matohiti edhe Oficcinë **ia** kemi dërguar fondit të zhvillimit edhe jemi në pritje Investim me buxhetin e bashkisë është e pamundur

**Anëtar i Këshillit z. Erald Ccepele**: Në Verbas Rruga Hyqmet Diza kërkon ndërhyrje Rruga nga Shtëpia e Bardhë deri te Albpetroli të bëhet më asfalt



**Anëtar i Këshillit**
**z. Erald Ccepele**

Dëgjesë Publike me temë :

*"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*

Prill 2024

**Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj**: ndonjë pyetje tjetër?

**Kryetar i fshatit Drenie Shaban Lazaj:** në fshatin Drenije kemi këto probleme kryesore: Rruga e fshatit dhe dricimi, Varrezat publike si dhe rrugët e parcelave



**Kryetar i fshatit Drenie**
**Shaban Lazaj**

Dëgjesë Publike me temë :

*"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*

Prill 2024

**Anëtar i Këshillit z. Klaudio Alisinanaj:** lagjja e Re Vazhdimi i investimit te Përroi Fasadat e pallateve duhet të jenë në vëmendjen e Bashkisë.



**Anëtar i Këshillit**
**z. Klaudio Alisinanaj**

Dëgjesë Publike me temë :

*"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*

Prill 2024

**Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro:** Për fasadat projekti është cuar në fondin e zhvillimit për investim. Në lagjjen e Re janë gjashtë sheshe pushimi ndersa dy janë të planifikuara per shtrim duke perfshire edhe KUZ dhe do të shikohet edhe per te nderhyre në lagjjen Vresht, pjesa veriore e lagjes Naftëtari do të ndërhyet në rikonstruksionin urban. Rruga e Gjinoqarës do të ndërhyet qysh këtë vit. Në fshatin Drenie do të ndërhyet në pjesën e siperme të fshatit deri ne qendër te tij

por nga qershori apo korriku. Lidhur mbi tregun e kemi përcaktuar që këtë vit për tregun por kemi një problem, gjetjen e vendit edhe përpara se të bëhet si investim do të bëjmë edhe një dëgjesë publike mbi percaktimin e vendit pasi duhet te jete nje studim i mirfillte per percaktimin e vendit ku do te ndertohet. Nderhyrjet te rruga e taracave ne lagjjen 29 Marsi, ka një problem pasi eshte lidhur me infrastrukturën e objekteve ekzistuese por ehe aty do te behet nje studim per te pare se ku do te nderhyet per rehabilitimin e asaj zone ndersa lidhur mbi problemin e rruges përreth cerdhes do të rehabilitohet se shpejti.



**Kryetar i Bashkisë**
**z. Fation Duro**

Dëgjesë Publike me temë :

*"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*

Prill 2024

**Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj:-** faleminderit Kryetar për gjitha sqarimet dhe orientimet e dhëna. Ndonjë pyetje apo kërkesë tjetër, mqse jo takimin e konsideroj të mbyllur.

**Konceptoi:**
**Koordinator i Konsultimit Publik**
Suzana **Hysenaj**

**Pranoi:**
**Sekretar i Këshillit**
Refaela **Xeba**

**Tema e Konsultimit:** *"Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".*





*Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*





Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos